



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca: 626/18/045/236

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Menaxherit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Dhe

Operatori Ekonomik **N.P. "GONI-ING"** me numër të biznesit **70580144**, selia në Suharekë të cilën e përfaqëson z. Agron Elshani, në cilësinë e Drejtorit (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

Titulli i kontratës: "HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHË PËR VITIN 2019" me numër Identifikues **626-18-9454-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë hartimi i projekteve ekzekutive si më poshtë:

Nr	Emri i objektit ndertimor	Tipi i objektit	Njësia	Sasia
1	Projektimi i urave dhe mbrojtëseve metalike	Projekt i ri	m ²	210
2	Projektimi i mureve mbrojtëse	Projekt i ri	m'	800
3	Projektimi i rrjetit të kanalizimit fekal	Projekt i ri	m'	2500
4	Projektimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik si dhe kanaleve të hapura	Projekt i ri	m'	1900
		Riparim		340
5	Projektimi i rrugëve	Projekt i ri	m'	1500
		Riparim	m ²	480
6	Projektimi i rrugëve fushore	Projekt i ri	m'	1500
7	Prjektimi i vorrezave	Projekt i ri	m ²	600

8	Objekte shkollore	Renovim	m ²	1500
9	Objekte Kulturore dhe sportive	Projekt i ri	m ²	1560
10	Projektimi i ndriqimit	Projekt i ri	m'	450
		Riparim		850
11	Objekte shëndetësore	Projekt i ri	m ²	1600
12	Projektimi i shtretërve të lumenjeve	Projekt i ri	m'	6500
13	Projektimi i parqeve	Projekt i ri	m'	650
		Riparim		1450
14	Projektimi i shesheve	Projekt i ri	m'	1400
15	Projektimi i sistemit të ngrohjes qendrore	Projekt i ri	m ²	950
16	Projektimi i objekteve të ndryshme	Projekt i ri	m ²	1200

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të sajë nga palët kontraktuese dhe përfundon pas kryerjes së shërbimeve të parapara me planin dinamik të paraqitur nga kontraktuesi.

1.3 Afati kohor i realizimit të hartimit të projekteve nuk mund të jetë më shumë se 60(Gjashtëdhjetë) ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në Komunën e Mamushës dhe në byronë projektuese të kontraktuesit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP1 (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4.101,40 €;**
Katërmijë e njëqind e një Euro e Katërdhjetë Eurocent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është shuma e vetme të cilën Autoriteti Kontraktues duhet t'ia paguaj Kontraktuesit në bazë të kësaj kontrate. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas kryerjes së shërbimeve nga Operatori Ekonomik dhe pas pranimit të faturës dhe vërtetimit të kryerjes së shërbimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe detyrës projektuese.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë shërbimet e ofruara, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, për të kryer shërbimin sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal

që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet të jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Agron Elshani	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i zyrës së prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	21.01.2019	Data:	21.01.2019
Vula:		Vula:	



Numri i Prokurimit: 626-18-045-2-3-6

**Titulli "HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË
MAMUSHË PËR VITIN 2019"**

Çmimet të llogariten me të gjitha tatimet e aplikuara në Kosovë

Nr	Emri i objektit ndertimor	Tipi i objektit	Njësia	Sasia	Çmimi në euro për njësi të projektit kryesor (zbatues) me të gjitha fazat e nevojshme	Totali	
1	Projektimi i urave dhe mbrojtëseve metalike	Projekt i ri	m ²	210	0.01	2.10	✓
2	Projektimi i mureve mbrojtëse	Projekt i ri	m'	800	0.01	8.00	✓
3	Projektimi i rrjetit të kanalizimit fekal	Projekt i ri	m'	2500	0.25	625.00	✓
4	Projektimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik si dhe kanaleve të hapura	Projekt i ri	m'	1900	0.25	475.00	✓
		Riparim		340	0.01	3.40	✓
5	Projektimi i rrugëve	Projekt i ri	m'	1500	0.29	435.00	✓
		Riparim	m ²	480	0.01	4.80	✓
6	Projektimi i rrugëve fushore	Projekt i ri	m'	1500	0.01	15.00	✓
7	Projektimi i vorrezave	Projekt i ri	m ²	600	0.01	6.00	✓
8	Objekte shkollore	Renovim	m ²	1500	0.01	15.00	✓
9	Objekte Kulturore dhe sportive	Projekt i ri	m ²	1560	0.01	15.60	✓
10	Projektimi i ndriqimit	Projekt i ri	m'	450	0.01	4.50	✓
		Riparim		850	0.01	8.50	✓
11	Objekte shëndetësore	Projekt i ri	m ²	1600	0.45	720.00	✓
12	Projektimi i shtretërve të lumenjeve	Projekt i ri	m'	6500	0.25	1,625.00	✓
13	Projektimi i parqeve	Projekt i ri	m'	650	0.05	32.50	✓
		Riparim		1450	0.01	14.50	✓



Numri i Prokurimit: 626-18-045-2-3-6

Titulli "HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË
MAMUSHË PËR VITIN 2019"

14	Projektimi i shesheve	Projekt i ri	m'	1400	0.05	70.00	✓
15	Projektimi i sistemit te ngrohjes qendrore	Projekt i ri	m²	950	0.01	9.50	✓
16	Projektimi i objekteve te ndryshme	Projekt i ri	m²	1200	0.01	12.00	✓

Gjithsejt:

4,101.40

Vërejtje: Tek objektet duhet të prezantohen edhe projektet idore .



Goshet